



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 24.05.2023

Nr: 138

Ora: 15:50

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 76, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar nga z. Franci Nuri

PALË E INTERESUAR: "Partia Socialiste e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Eridian Salianji

OBJEKT:

1. Kundërshtim i vendimit nr. 533, datë 18.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023".
2. Rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore, bashkia Belsh dhe miratimi i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore bashkia Belsh, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave.



3. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore bashkia Belsh.

4. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar bashkia Belsh, duke mospërfshirë rezultatin e QV nr. 2560/01 IEVP Burgu Kosovë.

5. Shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar bashkia Belsh të z. Bedri Qypi.

BAZË LIGJORE:

Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 76 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 24.05.2023, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 76 i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Gjatë seancës paraprake, subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Eridian Salianji depozitoi kërkesën nr.5419 prot., datë 24.05.2023, për të marrë pjesë si palë e interesuar në seancën e shqyrtimit të kërkesës ankimore. Kjo kërkesë u pranua nga KAS.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 76, datë 22.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 30.05.2023, ora 12:30.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar